Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

## Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

*b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

*c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

*ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

*d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

*dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:**

- Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

### **2.2.Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje të çertifikuar të bilanceve për dy vitet të fundit ushtrimor (2017,2018,2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuar nga ky autoritet.

2.2.2 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore për tre vitet e fundit (2017,2018,2019), lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera e se ciles duhet të jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit.

2.2.3. Vërtetim lëshuar nga institucionet përkatëse për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, ku subjekti.

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit të sukseshme të kryera gjatë tre viteve të fundit financiar në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

### **Per te vertetuar pervojen e meparshme detyrimisht te paraqiten dokumentat si me poshte:**

a.Kur kontratat janë të realizuara me institucione shtetërore ofertuesi duhet të paraqesë kontratën e lidhur me Institucionin të shoqëruar me vërtetim për realizimin të shoqëruar me faturën tatimore, ku të shënohet data, vlera, dhe shërbimet e realizuara.

b.Kur kontratat janë të realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara, të firmosura dhe të vulosura nga të dy palet).

## 2.4 Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

### Punime të përgjithshme ndërtimi

**NP- 1** Punime gërmimi në tokë.

**NP- 4** Rrugë autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai.

**NP- 5** Punime nëntoksore, ura dhe vepra arti.

**NP- 9** Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime

**NP- 11** Ndërtime për N/ stacione, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e enërgjisë.

**NP- 12** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

### Punime speciale ndërtimi

**NS- 1** Punime për prishjen e ndertimeve.

**NS- 6** Sinjalistika rrugore jo ndriqese.

**NS- 7** Barriera dhe mbrojtje rrugore.

**NS- 10** Shtresa dhe mbistruktura speciale.

**NS- 18** Punime topogjeodezike.

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vëndi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të këte në liçencën e tij ato kategori punimesh të kërkuar në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numer kategorie me kategorinë e punimeve në liçencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vëndi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë liçencën përpara lidhjes së kontratës dhe fillimit të punimeve sipas legjislacionit përkatës.*

**2.5.** Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë (Drejtues teknik) personeli si më poshtë:

- **1 (një)** – Inxhinier Hidroteknik
- **1 (një)** – Inxhinier Gjeodet
- **1 (një)** – Inxhinier Mekanik
- **1 (një)** – Inxhinier Elektrik

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si më poshtë:

- Diploma.
- Liçencat profesionale personale të mbikqyrjes.
- CV.
- Kontrata e punës.
- Libreza Pune.

Stafi Kryesor, Inxhinieri Hidroteknik, Inxhinieri Gjeodet, Inxhinieri Mekanik, Inxhinieri Elektrik, Inxhinieri Gjeolog, duhet të jenë pjesë e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shkurt 2020- Korrik 2020, për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat.

**2.6.** Operatori ekonomik duhet të ketë staf mbështetës të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit:

- **1 (një)** – Inxhinier Ndërtimi, me jo më pak se 10 vite eksperiencë. Për këtë të paraqesë, Kontratë pune, diplomë dhe CV.
- **1 (një)** punonjës i pajisur me çertifikatë për Ndihmën e Parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara. Për këtë të paraqesë, kontratë pune dhe çertifikatën e kualifikimit.
- **1 (një)** punonjës i paisur me çertifikatë për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Për këtë të paraqesë, kontratë pune dhe çertifikatën e kualifikimit.
- **1 (një)** punonjës Ekspert të vlerësimit në mjedis. Për këtë të paraqesë, kontratë pune dhe licencën për ndikimin e mjedisit.

Stafi mbështetës, Inxhinieret e Ndërtimit, Specialisti për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, Specialisti për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, Eksperti për vlerësimin në mjedis duhet të jenë pjesë e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shkurt 2020 – Korrik 2020, për këtë si dëshmi duhet të dorëzohet listëpagesa.

**2.7.** Operatori Ekonomik duhet të ketë jo më pak se 14 (Katëmbëdhjetë) punonjës të siguar për periudhën Janar 2020 – Korrik 2020, si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë:

**a.** Vertetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Janar 2020 – Korrik 2020, shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni tatimor. Si edhe formularët e deklarimit të pagave.

**2.8.** Operatori ekonomik duhet të jetë i paisur me këto çertifikata në përputhje me objektin e prokurimit:

- a- Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertifikatë EN-ISO, 9001 : 2015 të vlefshme.



- b- Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një certifikatë BS-ISO, 39001 : 2012 të vlefshme.
- c- Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një certifikatë EN-ISO,14001: 2015 të vlefshme.
- d- Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një certifikatë BS OHSAS, 18001:2007 të vlefshme.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtarë i grupit duhet të paraqesë Certifikatën e mësipërme.*

## **2.9. Ofertuesi të ketë në pronësi ose me qera dy automjete.**

- a- Automjeti në pronësi të shoqërohet me akt pronësie origjinal ose kopje te noterizuar ose me kontratë shiteblerje apo kontrate dhurimi.
- b- Automjeti me qera te shoqërohet me kontratë qeraje të noterizuar.

Për automjetin duhet të paraqitet dhe dokumenti që verteton regjistrimin e auttomjetit (leje qarkullimi, kolaudimin, siguracion, certifikatën e pronësisë).

**2.10** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një analizë të çmimit mbi tarifën/at profesionale të ofruara, duke specifikuar saktë të gjithë elementet që ka marrë parasysh në llogaritjen e çmimit, si dhe duke plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, sipas grupeve tarifore dhe ndarjeve funksionale te parashikuara ne kete vkm.

Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

***Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen.***

*(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 8

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

*Bashkengjitur jane projekti tip dhe planvendosja e punimeve te kontratës objekt mbikqyrjeje.*

Specifikimi i Materialeve:

*Bashkengjitur jane specifikimet teknike te punimeve te kontratës objekt mbikqyrjeje.*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

*Bashkengjitur preventivi i punimeve te kontratës objekt mbikqyrjeje.*

### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

**Shtojca 10**

*(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:** “SHËRBIMI MBIKQYRJE PUNIMESH-SUPERVIZION I OBJEKTIT: “MIREMBAJTJA, SISTEMIMI DHE ASFALTIMI RRUGEVE RURALE (RRUGE KOMUNALE), NE BASHKINE LEZHE”

Afatet e ekzekutimit: 36 Muaj nga lidhja e Marreveshjes kuader..

## Shtojca 11

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Shërbimi Mbikqyrje Punimesh me objekt: “Mirembajtja, Sistemimi dhe Asfaltimi rrugeve rurale (rruge komunale)”, ne Bashkine Lezhe

Detyrat: Mbikqyrja e Punimeve

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ne Njesite Administrative ne administrim te Bashkise Lezhe.

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga sipërmarrësi i cili do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërkohet nga investitori.

Objekte të shërbimit të mbikëqyrjes janë: Sipas relacionit teknik të bashkëngjitur në SPE.

#### • **Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyrësit**

- 2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:
  - Të mbikqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Kontraktor dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislativës në fuqi.
  - Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilesinë e punimeve, si dhe zbatimin të VNM në baza të standardeve të përcaktuara me ligj (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998, UKM Nr. 3, dt. 15.02.2011, UKM Nr. 1, dt. 22.02.2005, UKM Nr. 2, dt. 13.05.2005). Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor stafin e tij mbikqyrës, siç është përcaktuar në kërkesat e stafit kryesor.
  - Në baza të volumit të punimeve dhe vlerës së kontratës Mbikqyrësi i punimeve duhet të jetë rezident me kohë pune të plote në objekt, ndërsa stafi tjetër mbikqyrës mund të jetë rezident në objekt me kohë të pjesshme.
- 2.2 Mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin, etj.
- 2.3 Mbikqyrësi ve në dëgjim Autoritetin Kontraktor për nenkontraktoret e mundshme që zgjedh Sipërmarrësi (Zbatuesi i Punimeve) në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve.
- 2.4 Mbikqyrësi në fillim të punimeve në objekt, merr kontakt me organet qeverisëse, në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me legjislativën në fuqi (Neni 9, ligji Nr. 8402, dt. 10.09.1998).

#### 3. **Detyrat e mbikqyrësit**

- 3.1 Mbikqyrësi ka për detyrë:

- Te beje verifikimin e te gjithë dokumentacionit perkates te licensave, te autorizimeve dhe te lejeve, te cilat sipas dispozitave ne fuqi duhet te merren para fillimit te punimeve.
  - Te beje verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe gati per te filluar punimet.
  - Te njihet me hollesi me kontraten e zbatimit te punimeve dhe te gjithë akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.
  - Te kontrolloje vendosjen e tabelës se identifikimit te objektit me te dhenat e meposhtme:
    - Emertimi i objektit:
    - Data e marrjes se lejes se ndertimit:
    - Investitori:
    - Projektuesi:
    - Sipermarresi dhe drejtuesi teknik:
    - Mbikqyresi:
    - Afati i ndertimit te objektit:
    - Vlera e objektit:
- 3.2 Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet :
- Te marre masat e duhura per sigurine e objektit duke kontrolluar vendosjen ne objekt te tabelave perkatese sinjalizuese, treguese e te sigurise, shiritave, fenereve, etj.
  - Mbas verifikimit te dokumentacionit duhet te dorezoje prane Autoritetit Kontraktor te gjithë dokumentacionin, si dhe shkresen per fillimin e punimeve ku te perfshihen:
    - Stafi i Sipermarresit
    - Makinerite qe do perdoren per ndertimin e objektit
    - Pikat e marrjes se lendeve te para inerte
    - Zonat e ngritjes se kantjerit
  - Para fillimit te punimeve verifikon te gjitha pajisjet dhe makinerite e Sipermaresit, per te pare nese ato i pergjigjen kushteve te kontrates se zbatimit.
  - Te kontrolloje zbatimin e projektit duke u bazuar ne projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe te propozoje modifikimet, plotesimet dhe mosperputhjet, nese ka, dhe ti propozoje Autoritetit Kontraktor zgjidhjet konkrete.
  - Te ndjeke ne menyre te vazhdueshme e te kualifikuar te gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacione qe duhen te mbahen gjate zbatimit te punimeve, miratimin e analizave te veçanta, duke dhene udhezime, porosi e urdhera per zbatimin me perpikmeri e ne kohe te projektit, te kushteve teknike te projektimit dhe zbatimit te dispozitave perkatese te kontratave.
  - Te kontrolloje ne menyre korekte dhe te vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material qe vendoset ne veper, menyren e vendosjes se tij dhe cilesine e tij.
  - Per çdo punim te maskuar te beje (fotografimin ose regjistrim e tij dhe te mbaje proces-verbal te firmosur prej tij dhe sipermaresit.
  - Ne çdo fund dite pune te kontrolloje ditarin e punimeve dhe te firmose ate.
  - Te kontrolloje librezën e masave, e cila verteton volumin e punimeve dhe ta miratoje ate.
  - Te kontrolloje çertifikatat e cilesise se materialeve dhe te jape miratimin per vendosjen e tyre ne objekt.

- Gjate zbatimit te projektit, i jep udhezime me shkrim Sipermaresit, sa here qe e sheh te nevojshme dhe Sipermaresi eshte i detyruar t'i zbatoje ato. Ky i fundit, ka te drejte te beje me shkrim verejtjet e tij lidhur me udhezimet dhe urdherat e marra.
  - Per çdo rast, qe gjate zbatimit te punimeve lind nevoja e ndryshimeve ne projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyresi i punimeve duhet t'i paraqese Autoritetit Kontraktor nje relacion te plote teknik, shoqeruar me skicat perkatese ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi ne objekt, gjate zbatimit te punimeve, do te behet vetem pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor.
  - Ne çdo fund muaji, Mbikqyresi ka per detyre te paraqese prane Autoritetit Kontraktor raport mujor te punimeve. Ne kete raport duhet te jepet nje tablo e qarte e progresit te punimeve dhe te pagesave te kryera, realizimi i punimeve ne vlere dhe %, afati kohor, realizimi i financimit.
  - Korrespondenca ndermjet paleve behet gjithnje ne menyre zyrtare, me shkrim.
- 3.3 Raporti Mujor do te permbaje lenden e meposhtme:

- Hyrje
- Informacion i pergjithshem
- Te pergjithshme
- Qellimi i punimeve
- Mbikqyrja e punimeve ndertimore
- Personeli i siguruar nga Mbikqyresi
- Stafi i nevojshem ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve
- Stafi aktual
- Koheqendrimi ne objekt per secilin pjesetar te stafit mbikqyres
- Raportimi
- Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes
- Pershkrimi i Projektit
- Karakteristikat teknike dhe te dhena per objektin specifik
- Organizimi i Sipermaresit
- Sipermaresi
- Stafi prezent
- Mjete dhe makineri
- Koheqendrimi ne objekt
- Progresi Mujor
- Pershkrim te Punimeve qe jane kryer gjate muajit (sipas zerave dhe piketave)
- Fotografi te proçeseve te punimeve te kryera
- Fotografi te punimeve te maskuara per çdo punim te padukshem
- Grafiku i ecurise se punimeve
- Te aprovuara
- Te kryera
- Volumet Progressive te Punimeve Mujore
- Punimet e Aprovuara
- Çertifikatat e cilesise dhe Provat Laboratorike
- Libreza e Masave
- Punimet e Kryera por te pa aprovuara
- Situacionet mujore

- Matjet topografike
- Korrespondenca
- Proces-Verbale
- Urdhera, Udhezime, Njoftime
- Ndryshime ne Projekt - Preventiv nese ka (te aprovuara nga Autoriteti Kontraktor)
- Moti (kalendarik)
- Problemet qe kane dale
- Teknike
- Sociale
- Konkluzione

#### **4. Pergjegjesite e Mbikqyresit**

4.1 Ne fillim te punimeve Mbikqyresi mban dhe ka pergjegjesi per dokumentacionin e meposhtem:

- Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori se bashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik te bazamentit ku do te kryhen punimet.
- Dokumentacionin per realizimin e punimeve te objektit sipas projektit, kushteve teknike te zbatimit ne fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Sakesine e vertetesine e dokumenteve, volumet dhe cilesine e punimeve te ndertimit.
- Per realizimin me korrektesi te kontrates se nenshkruar midis Sipermaresit dhe Autoritetit Kontraktor, per realizimin e te gjithe fazave te zbatimit te punimeve, respektimit te afatit te dorezimit si dhe te koston se objektit.
- Asnje punim nuk do te mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipermaresi duhet te njoftoje Mbikqyresin kur eshte gati per t'u ekzaminuar prej tij.
- Ruajtjen e te gjithe dokumentacionit dhe korespondencen me Autoritetin Kontraktor, urdherat e ndryshme qe ai ka dhene gjate zbatimit te kontrates, kundershite dhe kontradiktat e lindura gjate punes, nderprerjet e punimeve dhe shkaqet qe i kane diktuar keto nderprerje, relacionet teknike te kerkuara ose te paraqitura gjate zbatimit, si dhe te gjitha rrethanat e nevojshme per te dhene kuadrin e plote te te gjithe fazave te zbatimit te punimeve.
- Ne rast se gjate zbatimit te kontrates kemi ndërrim te Mbikqyresit, per dorezimin e gjithe dokumentacionit qe disponon Mbikqyresi, i gjithe dokumentacioni dorezohet me proces-verbal ku shenohen dhe shkaqet e ketij nderrimi.

#### **5. Te drejtat e Mbikqyresit**

5.1 Mbikqyresi ka te drejte:

- Te kerkoje largimin nga puna te Drejtuesit te Kantierit ose te punetoreve te veçante per mosbindje, paaftesi ose pakujdesi te rende.
- Te mos pranoje drejtues teknik, manovrator, punetor, etj, nqs keta nuk plotesojne kushtet per te kryer detyren e caktuar.
- Te pezulloje punimet kur sheh se ne objekt nuk jane marre masat e duhura per te siguruar punimet dhe trafikun.



- Te kerkoje çertifikatat e cilesise se pajisjeve qe kryejne testet e materiale.
- Te kerkoje dhe te asistojne ne kryerjen e provave te materialeve, per te verifikuar cilesine e tyre. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Te mos lejoje vendosjen ne veper te materialeve qe nuk plotesojne kushtet e cilesise dhe ti zevendesojne ato me materiale te tjera nga Sipermaresi me shpenzimet e tij.
- Te kerkoje per te gjitha makinerite qe punojne ne veper dokumentacionet teknike per te siguruar nje ecuri punimesh te sigurta dhe cilesore.
- Te mos lejoje perdorimin e makinerive dhe pajisjeve te ndryshme nqs ato jane jashte kushteve teknike.
- Ne rast se materialet dhe pajisjet e perdorura nuk miratohen nga Mbikqyresi keto duhet te dokumentohen me proces-verbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara referuar standardeve te percaktuara ne specifikimet teknike te projekt-zbatimit.
- Te kerkoje kryerjen e provave shtese per materialet e vendosura ne objekt, kur keto nuk jane kryer ne masen sipas vellemeve te realizuara dhe pjese se lendes se pare te furnizuar per te verifikuar cilesine. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Kur Mbikqyresi i punimeve mendon se ka demtime ne konstruksion, kerkon te behen verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejte Mbikqyresit, shpenzimet jane ne ngarkim te Sipermaresit. Ne rast te kundert, Sipermaresi ka te drejte te kerkoje shlyerjen e shpenzimeve.
- Mbikqyresi i punimeve urdheron Sipermaresin te prishe dhe te ribeje me shpenzimet e tij, punime te bera jo me cilesine e parashikuar ne projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet, per ekzekutim teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, per çdo rast, me miratimin e Autoritetit Kontraktor per aq kohe sa ai e konsideron te arsyeshme. Ne kete rast, sipas fajtit, Mbikqyresi se bashku me Autoritetit Kontraktor dhe Sipermaresin percaktojne zgjatjen ose jo te afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyresi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor.

#### 5.2 Ne perfundim te punimeve Mbikqyresi:

- Merr me shkrim njoftimin per perfundimin e punimeve dhe verteton ne proces-verbal daten e perfundimit te tyre sipas projektit, te ndryshimeve te urdheruara e te kushteve te kontrates dhe brenda 30 diteve merr prej Kontraktorit dokumentacionin perkates.

Ne rast kur Mbikqyresi nuk arrin te marre dokumentacionin perkates brenda ketij afati, per shkaqe qe nuk mund ti ngelen Kontraktorit (Sipermaresit e punimeve), do te aplikohen dëme te likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve dhe do të llogariten me tarife ditore 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

- Sipas legjislacionit ne fuqi dorezon prane Autoritetit Kontraktor te gjithë dokumentacionin perkates per te cilin mban pergjegjesi te plote ne plotesimin, sakesine dhe vertetesine e tij.

#### 5.3 Ky dokumentacion duhet te permbaje :

- Proçes-verbalin e dorezimit te sheshit te ndertimit
- Proçes-verbalin per fillimin e punimeve
- Kontraten e Sipermarrrjes
- Kontraten e Mbikqyrjes

- Projekt organizimin e punimeve
  - Projektin teknik te zbatimit
  - Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqeruar me korrespondencen, skicat perkatese dhe miratimet e nevojshme
  - Preventivin fitues
  - Preventivin e ndryshuar (nese ka zerat te rinj te punimeve, negocimin e tyre)
  - Grafikon e punimeve
  - Specifikimet teknike
  - Azhornimin para fillimit te punimeve dhe piketimi
  - Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinjerik per punime te paparashikuara
  - Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi per punimet e padukshme
  - Proçes-verbalet e çdo punimi te maskuar te firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi te shoqeruar me fotografi
  - Ditarin e objektit ku te pasqyrohen dhe ndryshimet e urdheruara nga Mbikeqyresi
  - Librezen e masave
  - Çertifikatat e cilesise se materialeve
  - Miratimin e materialeve te perdorura nga Mbikqyresi
  - Situacionet pjesore dhe situacioni perfundimtar
  - Regjistrin e kontabilitetit
  - Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
  - Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
  - Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi, se bashku me matjet faktike te objektit te ndertuar
  - Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit
- 5.4 I gjithe dokumentacioni duhet te kete miratimin e Mbikqyresit. Ky dokumentacion pergatitet e dorezohet ne 3 (tre) kopje.
- 5.5 Sipas legjislacionit ne fuqi dorezon prane Autoritetit Kontraktor te gjithe dokumentacionin perkates per te cilin mban pergjegjesi te plote ne plotesimin, saktesine dhe vertetesine e tij:
- Nje kopje e te gjithe dokumentacionit dorezohet prane grupit te kolaudimit qe ngrihet brenda 30 diteve nga perfundimi i objektit. Te gjithe dokumentat qe dorezohen prane grupit te kolaudimit duhet te jene origjinale.  
Ne rast kur Mbikqyresi nuk arrin te dorezoje dokumentacionin perkates brenda ketij afati, do te aplikohen dëme te likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve dhe do të llogariten me tarife ditore 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
- 5.6 Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne Kolaudimin e objektit dhe i pergjigjet grupit te kolaudimit per te gjithe dokumentacionin e nevojshem gjate kolaudimit te objektit dhe firmos. Pas perfundimit te kolaudimit, Mbikeqyresi i punimeve mbeshetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjetër, percakton vleren perfundimtare te objektit, e cila i behet e ditur Sipermaresit dhe i jepet per te likuiduar Autoritetit Kontraktor.
- 6. Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes**
- 6.1 Sherbimi i mbikqyrjes zgjat per gjithe periudhen e zbatimit te punimeve (sipas objekteve me kohe te plote te inxhinierit rezidente) dhe periudhes se garancise se

punimeve (kontroll cdo 4 muaj te gjendjes se objektit shoqeruar me raport).  
Ne rast kur Mbikqyresi nuk arrin te dorezoje raportin perkates per periudhen e garancise se punimeve, do te aplikohen dëme te likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve dhe do të llogariten me tarife ditore 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u paguar nga AK.

6.2 Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kerkoje largimin e Mbikqyresit kur verteton mangesi serioze ne veprimtarine e tij si:

- Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara
- Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre
- Mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato te preventivuara, tolerim te materialeve jashte cilesise se kerkuar, tolerim te punimeve jo me cilesine e kerkuar, tolerim te pajisjeve jashte kushteve teknike
- Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te urdheroje Mbikqyresin e punimeve per nderprerjen e punes deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundervajtje administrative, vendosen sanksione ne baze te legjislacionit ne fuqi.

## 6. Kohezgjatja e shërbimit te Mbikqyrjes

6.1 Shërbimi i mbikqyrjes zgjat per gjithe periudhen e zbatimit te punimeve sipas kontrates respektive te siper marrjes te nenshkruar me AK,

Ne perfundim te punes mbikqyresi i punimeve dorezon me proces verbal te investitori dokumentacionin teknik te mbajtur gjate zbatimit te punimeve.

## **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Afatet e ekzekutimit: **(36 Muaj)**

Afati i realizimit te mbikqyrjes se punimeve do te jete i njejte me afatin e realizimit te punimeve nga shoqeria ndertimore e cila do te zbatoje punimet.

**Shtojca 12**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**



## **Shtojca 15.**

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Shërbimet –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

